




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

29/05/2024

Nr/02/519

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, mbështetur në dispozitat e Rregullores Npi/01-228 për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve të Komunës së Shtimes si dhe në pajtim me nenin 54 të Statutit të Komunës së Shtimes, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni komunal për vlerësimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit me qëllim të për ndarjen sipas kriterëve të subvencioneve për fermerët kultivues të drithërave të bardha (misër) dhe kultivues të perimeve në serra dhe në fushë të hapur.
2. Anëtarët e Komisionit sipas pikës 1 të dispozitivit caktohen:
 1. Bashkim Ahmeti- kryesues
 2. Adelina Ismajli-anëtare
 3. Halil Kurtishi-anëtar
 4. Shqiprim Hyseni-anëtar
 5. Arben Deliu-anetar
3. Anëtarët e Komisionit i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi sipas përcaktimeve të Rregullores Npi/01-228 për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve të Komunës së Shtimes.
4. Mandati i Komisionit është i vlefshëm deri në përfundim të procedurave të ndarjes përfundimtare të subvencioneve sipas pikës 1 të dispozitivit.
5. Obligohet administrata komunale e Komunës së Shtimes për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

iu dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Arkivit

Kryetari i Komunes
z.Qemal Aliu